



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**

**DREJTORIA E MBROJTJES SOCIALE, ARSIMIT, KULTURËS DHE SPORTEVE  
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL**

Nr. 212 Prot.

Patos, më 19 / 01 / 2026

**MIRATOHET  
KRYETARI  
FATION DURO**

**PROJEKT-VENDIM**

Nr 01 Datë 19 / 01 / 2026

**PËR**

**“MBI KRITERET E PËRDORIMI TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-  
NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 PËR QIND”**

**KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS**

Në mbështetje të nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 55, pikat 2 dhe 6, shkronja “n” të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, i ndryshuar me V.K.M nr. 868, datë 29.12.2021, paragrafi IV, pika 3, Drejtoria e Mbrojtjes Sociale, Arsimit, Kulturës dhe Sporteve, Sektori i Shërbimit Social i propozon Keshillit Bashkiak kriteret për familjet në nevojë që do të trajtohen me fondin e kushtëzuar deri në 6% dhe të ardhurat e bashkisë:

1. Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda 3 muajve të fundit nëpërmjet regjistrit elektronik për ndihmë ekonomike dhe nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit.
2. Të mos jenë refuzuar nga sistemi i pikëzimit për deklaram të rremë.
3. Për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duhet të jetë kryer paraprakisht vlerësimi social-ekonomik në familje nga administratorët shoqëror sipas shtojcës 2 të vendimit nr 597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”.

4. Përparësia për përfitimin e ndihmës ekonomike për kategoritë që do të përfitojnë do të jetë sipas radhës se mëposhtme:
- a) Kryefamiljare gra të veja me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë ose të lartë.
  - b) Kryefamiljare gra të divorcuara me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë ose të lartë.
  - c) vajza nëna
  - d) Persona ne moshë madhore të mbetur vetëm në trungun familjar pas vdekjes së prindërve
  - e) Familje në vështirësi të madhe ekonomike pa asnjë lloj të ardhure tjetër.  
Për këto familje përparësi do të ketë gjendja social-ekonomike e përcaktuar nga formulari i vlerësimit social-ekonomik, ndaj numrit të pjestarëve të familjes.
  - f) Rastet kur kryefamiljari ose ndonjë antar madhor është i paaftë për të punuar, por për shkak të legjislacionit në fuqi nuk përfiton pagesën e PAK.
5. Nuk përfitojnë ndihmë ekonomike familjet që edhe pse plotësojnë kushtet e mësipërme:
- a) U propozohet qoftë edhe njëherë punë dhe nuk pranojnë të punojnë.
  - b) U propozohen kurse të formimit profesional dhe nuk pranojnë.
  - c) Refuzojnë vlerësimin social-ekonomik në familje nga administratori shoqëror i ndihmës ekonomike.
  - d) Fshehin informacione ose të ardhura nga puna e zezë.
6. Masa e pagesës për familjet përfituese të jenë sipas V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Per percaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” i ndryshuar.
8. Ngarkohet struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki të hartojë projekt- vendimet për familjet në nevojë nën juridiksionin e bashkisë, në bazë të propozimeve dhe vlerësimeve social-ekonomike të ardhura nga njësitë administrative, për trajtim me ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6 përqind.

**Zv. Kryetare**  
**Ina Sauli**



**P.sekt. Sh.Social dhe Barazisë Gjinore**  
**Barie Goxhaj**



**Drejtor**  
**Mitjon Nikolla**



**Juriste**  
**Joana Sherifi**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**

**DREJTORIA E MBROJTJES SOCIALE, ARSIMIT, KULTURËS DHE SPORTEVE  
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL**

Nr. 212/Prot.  
11

Patos, më 19 / 01 / 2026

**RELACION**

**PËR**

**“MBI KRITERET E PËRDORIMI TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-  
NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 PËR QIND DHE TË ARDHURAT E  
BASHKISË”**

Në mbështetje të nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 55, pikat 2 dhe 6, shkronja “n” të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, i ndryshuar me V.K.M nr. 868, datë 29.12.2021, paragrafi IV, pika 3, Drejtoria e Mbrojtjes Sociale, Arsimit, Kulturës dhe Sporteve, Sektori i Shërbimit Social i propozon Këshillit Bashkiak relacionin mbi kriteret për familjet në nevojë që do të trajtohen me fondin e kushtëzuar deri në 6% dhe të ardhurat e bashkisë:

Këshilli Bashkiak miraton në fillim të vitit kriteret për dhëniën e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese në sistemin e ndihmës ekonomike, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar ose nga të ardhurat e bashkisë.

Kriteret për tu përzgjedhur për tu trajtuar nga fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar ose nga të ardhurat e bashkisë:

1. Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda 3 (tre) muajve të fundit nëpërmjet regjistrit elektronik për ndihmë ekonomike dhe nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit.
2. Të mos jenë refuzuar nga sistemi i pikëzimit për deklaram të rremë.

Përparësi për përfitimin e ndihmës ekonomike do të kenë kategoritë e mëposhtme:

- a) Kryefamiljare gra të veja me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë ose të lartë.
- b) Kryefamiljare gra të divorcuara me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë ose të lartë.

- c) Vajzat nëna
- d) Persona në moshë madhore të mbetur vetëm në trungun familjar pas vdekjes së prindërve
- e) Familje në vështirësi të madhe ekonomike pa asnjë lloj të ardhure tjetër.  
Për këto familje përparësi do të ketë gjendja social-ekonomike e përcaktuar nga formulari i vlerësimit social-ekonomik, ndaj numrit të pjestarëve të familjes.
- f) Rastet kur kryefamiljari ose ndonjë anëtar madhor është i paafte për të punuar, por për shkak të legjislacionit në fuqi nuk përfiton pagesën e PAK.

Nuk përfitojnë ndihmë ekonomike familjet që edhe pse plotësojnë kushtet e mësipërme:

- a) U propozohet qoftë edhe njëherë punë dhe nuk pranojnë të punojnë.
- b) U propozohen kurse të formimit profesional dhe nuk pranojnë.
- c) Refuzojnë vlerësimin social-ekonomik në familje nga adimistratori shoqëror i ndihmës ekonomike.
- d) Fshehin informacione ose kryen deklaram të rremë.

Masa e pagesës për familjet përfituese të jenë sipas V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019

“Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” i ndryshuar.

**Sp. Mbrojtjes Sociale**

Grisilda Muçaj



**Drejtor**

Mitjon Nikolla



**Përgj.Sekt.Sh.Social dhe Barazisë Gjinore**

Barie Goxhaj



**ZËVENDËS KRYETAR**

Ina Sauli

